



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 15376 Prot

Shkodër, më 28.07.2025

VENDIM

Nr. 260 datë 28/07/2025

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqiperisë”;ligjit nr.9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperise” i ndryshuar; ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”; ligjit nr.89 datë.22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”; ligjit nr.114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar; Udhëzimit nr.30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 227, datë 30.06.2025.
2. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Alban Preka me detyrë zëvendeskryetar i bashkisë Shkodër;
 - për firmosje si nëpunës autorizues.
 - për firmosje si titullar i autoritetit kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik.

për të gjithë administratën bashkisë Shkodër.

 - për firmosje shkresore që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/ fizik dhe individ, për të gjitha drejtorite duke përjashtuar strukturat e deleguar sipas vendimit nr.258, datë 28.07.2025 dhe vendimit nr.259, datë 28.07.2025.
3. Zv/Kryetari nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
4. Kompetencat e deleguara sipas këtij vendimi do të ushtrohen duke filluar nga data 29.07.2025 dhe përfundojnë me datë 31.12.2025, ora 16.00.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Alban Preka dhe administrata bashkisë Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

